

DORACA

**PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË CILËSISË
NË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE**

Autore: Elizabeta Markovska Spasenoska

2018

Ky botim është përpiluar në kuadër të projektit «Avancimi i shoqërisë civile dhe promovimi i parimeve të qeverisjes së mirë nëpërmjet aplikimit të sistemeve të cilësisë së menaxhimit në organizatat e shoqërisë civile» me mbështetjen financiare të «CIVICA Mobilitas



Botues: Qendra për hulumtim e krijim të politikave

Për botuesin: Marija Risteska, drejtor ekzekutiv

Autor: Elizabeta Markovska Spasenovska

Shkup, 2018

Kontakt: crpm@crpm.org.mk

Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësia e Qendrës për Hulumtimin dhe Krijimin e Politikave dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Civica Mobilitas, Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ose organizatave që e zbatojnë atë.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	5
1.1 Nevoja për aplikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit.	5
1.2 Baza për dizajnin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit	5
2. Analiza krahasuese e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit	6
2.1 PQASSO – Sistemi praktik për sigurimin e cilësisë për organizatat e vogla.....	6
2.2 ISO9001.....	7
2.3 SOKNO	8
2.4 Modeli slloven i sistemit të sigurimit të cilësisë për organizatat qytetare.....	9
2.5 Global Accountability Standard.....	11
3. Modeli i sistemit për menaxhimin e cilësisë në kontekstin e sektorit civil të Maqedonisë.....	13
3.1 Karakteristikat e sistemit	13
3.2 Elementet e sistemit.....	13
4. Hapat e aplikimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë.....	16
5. Shtojcat	20

1. Hyrje

1.1 Nevoja për aplikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit

Sigurimi i shërbimeve me cilësi përkatëse dhe sipas standardeve të caktuara bëhet imperativ në të gjitha sferat. Pikërisht për këtë shkak, në nivel botëror një vëmendje gjithnjë më të madhe i kushtohet aplikimit të formave dhe mënyrave të menaxhimit dhe udhëheqjes së organizatave të cilat do të sigurojnë që shërbimet të realizohen në mënyrë më efikase dhe me një qasje të standardizuar, e cila do të garantojë cilësinë. Standardet e këtilla të menaxhimit dhe udhëheqjes, edhe pse në fillim mund të fillojnë në një departament ose segment të caktuar të organizatës, pastaj ato zgjerohen në nivelin e gjithë organizatës me qëllim që të shkaktojnë efekte dhe përmirësime sistemike në funksionimin e tërësishëm të organizatës. Aplikimi i ndryshimeve në një departament në afat të gjatë kërkon koordinim edhe me departamentet e tjera dhe funksionet organizative, kështu që mund të arrihet në një situatë ku praktikatat e mira ngadalë shndërrohen në zgjidhje dhe rregulla sistemike. Kjo qasje e menaxhimit të cilësisë së realizimit është e zbatueshme si në institucionet dhe organizatat publike, ashtu edhe në ato private, por edhe në sektorin civil.

1.2 Baza për dizajnin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit

Sigurimi i cilësisë në punën e organizatave të shoqërisë civile është kërkesë si nga donatorët, ashtu edhe nga vetë konstituentët dhe përdoruesit e shërbimeve dhe aktiviteteve të organizatës. Megjithatë, aplikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit duhet të bazohet në natyrën dhe dinamikën e punës së organizatës, si dhe në proceset e brendshme specifike të punës. Proceset e punës, megjithatë, mund të ndahen më tej në tre grupe themelore:

- Proceset e menaxhimit dhe udhëheqjes së organizatës, në të cilat përfshihen: menaxhimi strategjik, planifikimi vjetor, vlerësimi i punës;
- Proceset themelore të punës të cilat dalin nga veprimtaria primare ose misioni i organizatës, si për shembull: realizimi i shërbimeve të ndihmës juridike, realizimi i shërbimeve sociale, zbatimi i llojeve të caktuara të projekteve dhe ngjarjeve;
- Proceset e mbështetjes, në të cilat përfshihen: puna financiare, promovimi dhe marketingu etj.

Zbatimi i këtyre proceseve të punës përcaktohet si me kornizën ligjore ashtu edhe me praktikatat e mira të punës së organizatës, por edhe me kërkesat të caktuara specifike të vendosura nga ana e donatorëve dhe konstituentëve.

2.

Analiza krahasuese e sistemeve ekzistuese të menaxhimit të cilësisë së realizimit/operimit

Për pjesën e madhe të organizatave të sektorit civil, aplikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë në të gjitha tre nivelet e proceseve të punës është risi dhe kërkon përgatitje dhe edukim adekuat. Një çështje e veçantë që imponohet është se në cilin sistem të menaxhimit të cilësisë do të bazohet puna e një organizate të shoqërisë civile, duke pasur parasysh faktin se motivi i formimit dhe veprimit është i ndryshëm për lloje të ndryshme të organizatave ose konkretisht në sektorin civil dominon nevoja për të kontribuar për shoqërinë dhe për të arritur një dobi shoqërore nëpërmjet punës.

Ka një numër të madhe sistemesh të cilat i përdorin OSHC-të. Një pjesë e tyre janë zhvilluar posaçërisht për sektorin jofitimprurës, ndërsa një pjesë e tyre janë zhvilluar së pari për sektorin e biznesit dhe pastaj janë pranuar nga ana e OSHC-ve. Për nevojat e kësaj analize do të prezantohen shkurtimisht disa sisteme të cilat janë më të njohura në nivel global, por edhe sisteme të cilat përdoren nga ana e OSHC-ve në rajon për shkak të kushteve të ngjashme që sundojnë dhe mundësisë që në Maqedoni të aplikohet një sistem, i cili do të adaptohet në ndonjë prej sistemeve ekzistuese. Qëllimi i prezantimit të sistemeve nuk është që të dëshmohet se cili është më i miri, por për të ndihmuar palët e interesuara në Maqedoni që të marrin një vendim se vallë dhe çfarë lloj sistemi për sigurimin e cilësisë së menaxhimit të OSHC-ve është më i përshtatshëm për organizatat lokale në kontekstin e madhësisë dhe shkallës së zhvillimit të tyre.

2.1 PQASSO – Sistemi praktik për sigurimin e cilësisë për organizatat e vogla

Sistemi më i njohur në nivel global në sektorin jofitimprurës është sistemi PQASSO (Practical Quality Assurance System for Small Organizations), përkatësisht Sistemi praktik për sigurimin e cilësisë për organizatat e vogla. Ai është standard i cilësisë së zhvilluar nga ana Charity Evaluation Services (CES) dhe ka zbatim të gjerë nga organizatat jofitimprurëse në Britaninë e Madhe. Sistemi nënkupton qasje fleksibile dhe sistematike për menaxhim më të mirë me aktivitetet e organizatës si brenda saj, ashtu edhe dhe jashtë saj, e cila kontribuon për punë më efikase dhe më efektive të OSHC-ve. PQASSO përbëhet nga 12 fusha të cilësisë dhe tre nivele të arritjeve. Fillimisht, sistemi është dizajnuar si mekanizëm për vetëvlerësim, por tani ka PQASSO shenjën e cilësisë, që është një vlerësim i jashtëm i cili certifikon përputhshmërinë e OSHC-ve me standardet e PQASSO-së dhe është i vlefshëm për tre vjet.

Tabela 1. Fushat e cilësisë së PQASSO-së

1. Planifikimi	7. Menaxhimi i financave
2. Menaxhimi	8. Menaxhimi i resurseve
3. Lidhshipi dhe udhëheqja	9. Komunikimet dhe promovimi
4. Shërbimet e orientuara ndaj përdoruesve	10. Puna me të tjerët
5. Menaxhimi i resurseve njerëzore	11. Monitorimi dhe vlerësim
6. Mësimi dhe zhvillimi	12. Rezultatet

Zbatimi i sistemit PQASSO përfshin shtatë hapat:

1. Zbatimi i sistemit PQASSO – blerja e pakos së punës dhe bërja e vetëvlerësimit;
2. Aplikacioni për kontroll – plotësimi dhe dorëzimi i formularit të aplikacionit të PQASSO shenjës së cilësisë;
3. Planifikimi i kontrollit – vlerësuesi, i njohur si ekspert (peer reviewer) kontakton organizatën për t’u marrë vesh rreth datës së kontrollit të dokumentacionit, vizitës në terren;
4. Kontrolli i dokumentacionit – organizata ia dorëzon dokumentet e caktuara ekspertit për vlerësim;
5. Vizita në terren – eksperti viziton organizatën për të zbatuar intervista dhe për të mbledhur prova;
6. Njoftimi – eksperti përgatit raport të detajuar për gjetjet lidhur me organizatën dhe CES-in;
7. Marrja e mirënjohjes – nëse organizata është e suksesshme, merr PQASSO shenjën e cilësisë.

PQASSO shenja e cilësisë vlen për tre vjet. Pas skadimit të kësaj periudhe, organizata duhet të paraqitet për të kaluar përsëri nëpër proces ose të ndërpresë ta përdorë logon e shenjës së cilësisë.

2.2 ISO 9001

Njëri nga sistemet e cilësisë të cilat nuk janë zhvilluar enkas për OKQ-të, por mund t’i përdorin janë standardet ISO 9000, të cilat janë më të njohura në botë. Standardin ISO 9000, i cili është ripërtërirë në vitin 2015, mund ta përdorin të gjitha llojet e organizatave, pa dallim të madhësisë dhe shkallës së zhvillimit të tyre. Ky standard bazohet mbi shtatë parime të udhëheqjes cilësore:

1. Fokusi i përdoruesve – me qëllim që t’u dilet në ndihmë kërkesave të përdoruesve, madje edhe të tejkalohen pritjet e tyre;

2. Liderशिpi – liderët në të gjitha nivelet harmonizojnë dhe promovojnë qëllimet dhe drejtimet e vetme dhe krijojnë kushte në të cilat njerëzit (të punësuarit) angazhohen për të arritur qëllimet kualitative të organizatës;
3. Angazhimi i njerëzve - njerëzit kompetentë, të fortë dhe të angazhuar në të gjitha nivelet e organizatës janë të domosdoshëm që të përforcojnë kapacitetin e krijimit dhe realizimit të vlerave;
4. Qasja në proceset – rezultatet e qëndrueshme dhe të parashikueshme arrihen në mënyrë më efektive dhe më efikase kur aktivitetet kuptohen dhe menaxhohen si procese të ndërlidhura të cilat funksionojnë si sistem koherent;
5. Përmirësimi – organizatat e suksesshme vazhdimisht fokusohen në përmirësim;
6. Marrja e vendimeve në bazë të fakteve – marrja e vendimeve që bazohen në analizën dhe vlerësimin e të dhënave dhe informacioneve me siguri do të çojnë deri te rezultatet e dëshiruara;
7. Menaxhimi i marrëdhënieve të vendosura – për një sukses të qëndrueshëm, organizata menaxhon marrëdhëniet e saja me palët e interesuara, siç janë furnizuesit.

Certifikimi nuk është i domosdoshëm. Organizata mund të marrë vendim për të përdorur vetëm vetëvlerësimin (kontrollin e brendshëm). Nëse organizata merr vendim për certifikim, mund të kontaktojë autoritetin e certifikimit në vendin e saj. Për të marrë certifikimin pas kontrollit të zbatuar të brendshëm, organizata kontraktton një auditim të jashtëm, kështu që atë e vizitojnë një ose më shumë auditorë, varësisht nga madhësia e vetë organizatës dhe bisedojnë me të punësuarit. Pas vizitës lëshohet një raport dhe nëse identifikohen ndonjë parregullsi, organizata merr një afat për përjashtimin e tyre, pas çka kryhet pjesa e dytë e auditimit. Certifikata lëshohet pasi raporti do të shqyrtohet dhe miratohet nga një autoritet adekuat certifikues. Certifikata ka vlefshmëri prej tre vjetësh, por çdo vit duhet të zbatohet auditim i brendshëm dhe i jashtëm. Çdo autoritet certifikues organizon trajnime të ndryshme dhe publikon botime për implementim më të lehtë të sistemit.

2.3 SOKNO

Sistemi kroat SOKNO është një sistem i adaptuar, i cili bazohet në sistemin britanik PQASSO (i shqyrtuar më lart në këtë analizë). Ky sistem ka funksionuar në Kroaci në periudhën prej vitit 2002 deri në vitin 2012, kur ka përfunduar kontrata autoriale për përdorimin e këtij sistemi. Në këtë moment në fazën e zhvillimit është një sistem lokal, por ende nuk ka informata për llojin dhe strukturën e këtij sistemi.

Sistemi SOKNO mund të karakterizohet si sistem, i cili gjendet midis vetë-certifikimit dhe *peer review* si mekanizma. Fokusi i këtij sistemi është ndaj proceseve të cilat i përdor një organizatë për t'i realizuar produktet, shërbimet dhe aktivitetet e veta. Versioni i fundit i sistemit SOKNO mbulon 13 fusha, të cilat prezantohen më poshtë në tabelë.

Tabela 2. Fushat e cilësisë së sistemit SOKNO

1. Planifikimi i cilësisë	8. Menaxhimi i resurseve
2. Menaxhimi	9. Menaxhimi i parave
3. Udhëheqja	10. Trajnimi dhe zhvillimi
4. Shërbimet e fokusuara ndaj përdoruesve	11. Rrjetëzimi dhe përfaqësimi
5. Personeli	12. Monitorimi dhe vlerësimi
6. Vullnetarët	13. Rezultatet
7. Menaxhimi i aktiviteteve	

Sistemi SOKNO ka tre nivele të arritjeve. Niveli i parë (Niveli 1) vendos kërkesat minimale të cilat duhet t'i përmbushë një organizatë për të punuar në përputhje me ligjin dhe i ndihmon organizatat për t'i identifikuar dhe për t'i arritur të gjitha obligimet e tyre ligjore. Niveli i dytë (Niveli 2) përmirësohet në bazë të arritjeve të nivelit të parë në të gjitha fushat e jetës së organizatës, supozon se organizata i ka resurset për të shkuar përtej nivelit të parë dhe kërkon nga organizata që të ketë një qasje strategjike në realizimin e qëllimeve afatshkurtra dhe afatgjata. Niveli i tretë (Niveli 3) përmirësohet në bazë të të gjithë punës së mirë që është bërë në dy nivelet e para dhe kërkon nga organizata që të jetë lider i cilësisë së organizatave të tjera që punojnë në fushën e vet. Sipas sistemit SOKNO, secila organizatë duhet të arrijë Nivelin 1 në të gjitha 13 fushat. Duke arritur Nivelin 1 në zhvillimin e tyre, organizatat do të mund të tregojnë se i kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore dhe i mbrojnë të drejtat e përdoruesve të tyre, palëve të interesuara, të punësuarve dhe vullnetarëve. Kur Niveli 1 arrihet njëherë në të gjitha fushat, organizata mund të planifikojë përmirësimet e mëtejshme duke u fokusuar në dy nivelet e ardhshme.

2.4 Modeli slloven i sistemit të sigurimit të cilësisë për OSHC-të

Modeli slloven i sistemit të sigurimit të cilësisë për OSHC-të është zhvilluar në periudhën prej vitit 2005 deri në vitin 2007 nga ana e organizatës kombëtare ombrellë - Qendra për shërbime informative, bashkëpunim dhe zhvillim të OSHC-ve në partneritet me Institutin Slloven të cilësisë dhe metrologjisë. Sistemi është rezultat i nevojës për t'u mbrojtur transparenca, kredibiliteti dhe imazhi publik i sektorit të OSHC-ve dhe për këtë gjë janë pajtuar organizatat joqeveritare. Modeli fillimisht bazohet në standardin ISO 9001, i cili është harmonizuar me nevojat e OSHC-ve dhe janë përdorur elemente të sistemeve, siç janë PQASSO, SOKNO, Investimi në vullnetarë etj. Pilot-versioni i modelit është zbatuar në 14 organizata, të cilat kanë dhënë komente për versionin ekzistues dhe versionin final i modelit është zhvilluar në bazë të përvojave praktike të organizatave joqeveritare. Modeli slloven mbulon shtatë fusha, të prezantuara më poshtë në tabelë.

Tabela 3. Fushat të cilat i mbulon Sistemi slloven

1. Kërkesat e përgjithshme (në përputhje me ligjin)
2. Menaxhimi dhe udhëheqja (planifikimi strategjik, struktura udhëheqëse)
3. Të punësuarit dhe vullnetarët (menaxhimi i resurseve njerëzore)
4. Menaxhimi i resurseve (menaxhimi financiar, menaxhimi i pajisjeve)
5. Menaxhimi i proceseve (menaxhimi i projekteve, marrëdhëniet me donatorët, rrjetëzimi dhe partneriteti)
6. Monitorimi dhe vlerësimi
7. Përparimi i vazhdueshëm (Sistemi PDCA ¹)

Për aplikimin e këtij sistemi nevojiten këta hapa:

- OSHC standardi – organizata vetë ose me ndihmë të mentorit e kontrollojnë funksionimin e saj dhe identifikon se në cilat fusha duhet të përmirësohet.
- Doracak për cilësi – organizata përshkruan sistemin e saj të sigurimit të cilësisë në doracak. Doracaku është një dokument në të cilin organizata përshkruan se në cilën mënyrë e zbaton standardin.
- Punëtorja – organizata mund të marrë pjesë në një punëtori tregtare, të cilën e zbatojnë organizatat që e kanë zhvilluar sistemin, kështu që organizata gjatë punëtorisë mund t'i bëjë të gjitha përgatitjet për kontrollin e jashtëm.
- Kontrolli i brendshëm – një i punësuar nga organizata ose nga një organizatë partnere e bën kontrollin e brendshëm si indikator i brendshëm për gatishmërinë e kontrollit të jashtëm.
- Aplikimi për certifikim – organizata paraqitet (aplikon) për një kontroll të jashtëm.
- Kontrolli i jashtëm/Certifikimi – Në rast se organizata ka një certifikatë, njëherë në vit e viziton një vlerësues i jashtëm dhe përmes një kontrolli të detajuar dhe bisedave me të punësuarit kontrollojnë se si funksionon sistemi dhe përgatit një raport. Në bazë të raportit, Instituti i cilësisë dhe metrologjisë lëshon një certifikatë.
- Vërtetimi i certifikatës – Certifikata vlen për tre vjet, por çdo vit bëhet kontroll të jashtëm, i cili kërkon që organizata paraprakisht të bëjë edhe një kontroll të brendshëm.

Procesi në një organizatë mund të zgjasë prej tre deri në gjashtë muaj, varësisht nga ajo se organizata a e ka vizituar trajnimin, i cili e përshpejton procesin. Ky sistem është në fazën e përmirësimit që të harmonizohet me risitë të cilat gjenden në ISO 9001:2015.

1 PDCA – Plan-Do-Check-Act metodi i menaxhimit

2.5 Global Accountability Standard²



Standardi global është një standard referent që ndjek përgjegjësinë e organizatave të shoqërisë civile në një mënyrë dinamike. Standardi është zhvilluar nga ana e iniciativave të përgjegjësive nga Afrika, Azia, Australia, Evropa, Amerika Veriore, Amerika Latine dhe Karaibet. Standardi global përfshin **12 angazhime për Përgjegjësi dinamike**, të cilat organizatat e shoqërisë civile premtojmë se do t'i realizojnë, dhe aktivitetet kryesore, në bazë të të cilave ato mund të konsiderohen si përgjegjëse. Kjo është një kornizë shumë praktike që mund t'u përshtatet nevojave të ndryshme, kulturore, gjeografike dhe organizative, me udhëzime të vogla teknike, me një gjuhë të thjeshtë me më pak zhargon. Me qasjen e tij të thjeshtëzuar, por ende gjithëpërfshirëse, standardi global u mundëson organizatave të shoqërisë civile, pa marrë parasysh se cila është madhësia e tyre, që të përmirësohet praktika, përgjegjësia e tyre, e me këtë edhe efikasiteti i tyre.

Çfarë është standardi global? Termi Përgjegjësia dinamike përshkruan konceptin e organizatave të përgjegjshme të shoqërisë civile, që të punojnë në mënyrë transparente dhe të mësojnë nga palët e interesuara me qëllim që ta rrisin ndikimin dhe efektivitetin e tyre. Ky kuptim dinamik i përgjegjësive, që i vendos njerëzit në qendër të vendimmarrjes, është në zemrën e standardit global. Qëllimi i standardit global është të jetë një pikënisje për lëvizje globale të Përgjegjësive dinamike, duke u ofruar një kornizë për realizimin e qëllimeve dhe vlerave të përbashkëta, të cilat i bashkojnë organizatat e shoqërisë civile në mbarë botën. Nëse qasja dinamike ndaj llogaridhënies praktikohet nga ana e mijëra organizatave, atëherë ajo ka një potencial për të transformuar sektorin e shoqërisë civile në një aktor shumë të përgjegjshëm.

Kush mund ta përdorë atë? Standardi global mund të përdoret nga ana e nismave të përgjegjësive në mbarë botën për t'i harmonizuar standardet e tyre

² <http://www.csostandard.org/the-global-standard/>

ekzistuese ose për të zhvilluar standarde të reja të përgjegjësisë. Standardi nuk ka për qëllim t'i zëvendësojë ato. Nëse konceptet e ndryshme të përgjegjësisë harmonizohen në mbarë botën, do të ketë më shumë krahasueshmëri dhe kostot e transaksionit do të reduktohen. Standardi gjithashtu mund të përdoret në bazë vullnetare, si shembull nga:

- Organizatat e shoqërisë civile, rrjetet e organizatave joqeveritare dhe grupet e përfaqësimit – për përmirësimin e standardeve, praktikave dhe përgjegjësisë së tyre;
- Qeveritë dhe donatorët – që të krijohen rregullativa dhe politika të mundshme për financimin e organizatave të shoqërisë civile;
- Palët e interesuara – që të mirëmbahet përgjegjësia e sektorit civil;
- Me qëllim që të mundësohen partneritete efektive të organizatave të shoqërisë civile.

3.

Modeli i sistemit për menaxhimin e cilësisë në kontekstin e sektorit civil të Maqedonisë

3.1 Karakteristikat e sistemit

Duke pasur parasysh karakteristikat e sistemeve të cekura për menaxhimin e cilësisë në kuadër të analizës krahasuese dhe në bazë të praktikave dhe nevojave të konstatuara të 15 organizatave të shoqërisë civile, të cilat kanë fituar grante në programin CIVICA Mobilitas, u përgatit një model lokal i sistemit për menaxhimin e cilësisë. Modeli fokusohet, para së gjithash, në segmentet e ndryshme organizative në të cilat duhet të sigurohet cilësia, të cilat në esencë i paraqesin tre niveleve të proceseve organizative në organizatat e shoqërisë civile. Modeli është i harmonizuar me kërkesat e Global Accountability Standard dhe me Indeks të shoqërisë civile³, veçanërisht me kërkesat e dimensioneve 2 - niveli i organizimit dhe 3 – zbatimi i vlerave në praktikë. Në doracak në pjesët e mëposhtme do të prezantohen karakteristikat themelore të sistemit, segmentet dhe elementet që i mbulon.

Karakteristikat themelore të sistemit për menaxhimin e cilësisë janë:

- Është orientuar drejt funksioneve **kryesore** organizative;
- Konstaton ekzistimin, por mbi të gjitha **funksionalitetin** e proceseve dhe procedurave, seteve të kriterëve me të cilat rregullohet puna;
- Konstaton ekzistimin e **kapacitetit** për përmbushjen e kërkesave të caktuara profesionale (në sektorët tematikë ose në sektorin civil);
- Kërkon **vazhdimësinë** në punën e organizatave të shoqërisë civile;
- Kërkon zbatimin në praktikë të sistemit të **vlerave** të definuara të organizatave të shoqërisë civile;
- Propozon aplikimin e seteve të ndryshme të standardeve të nivelit themelor, e pastaj lart si **shkalla e zhvillimit** në të cilën mund të pozicionohen organizatat e shoqërisë civile;
- Ofron një **set formularësh** për një aplikim më të lehtë të standardeve/indikatoreve.

3.2 Elementet e sistemit

Modeli i sistemit të menaxhimit të cilësisë përfshin 10 fusha, të cilat në vetvete përmbajnë 33 standarde për aspekte të ndryshme të punës dhe tre nivele për realizimin e këtyre standardeve.

³ <http://mcms.mk/mk/za-nasata-rabota/istrazuvana-i-publikacii/767-irg102-civikus-indeks-na-graganskoto-opstestvo.html>

Fushat e sistemit janë:

1. Menaxhimi strategjik;
2. Menaxhimi me përdoruesit, anëtarësinë, përkrahësit dhe vullnetarët;
3. Puna në projekte;
4. Përfaqësimi;
5. Realizimi i shërbimeve dhe përkujdesja për përdoruesit;
6. Bashkëpunimi, partneritetet dhe rrjetëzimi;
7. Udhëheqja dhe struktura;
8. Menaxhimi i resurseve njerëzore;
9. Financat dhe administrata;
10. Komunikimet me publikun;

Paralelisht me këto fusha, gjatë aplikimit të sistemit, çdo organizatë rekomandohet që të përgatisë listë të vlerave dhe parimeve të funksionimit dhe përmes proceseve dhe procedurave të cilat i praktikon në kuadër të 10 fushave të cekura, të tregojë se si janë përfshirë dhe zbatohen ato vlera dhe parime. Në listën e vlerave mund të përfshiheshin: barazia gjinore, përfshirja e individëve, grupeve dhe komuniteteve të ndryshme, pjesëmarrja e përbashkët në vendimmarrje, transparenca, besimi dhe respektimi i ndërsjellë e kështu me radhë.

Rekomandohet që ky sistem për menaxhimin e cilësisë të aplikohet me zbatimin e metodës së vetëvlerësimit të mbikëqyrur, kurse vetëvlerësimi bëhet sipas indikatorëve që janë vendosur për secilën fushë.

Nivelet e vlerësimit janë:

- Ekziston dhe zbatohet: Ky nivel nënkupton se kërkesat/kriteret/shembujt që përmbahen në definicionin e atij indikatorit/standardi janë përmbushur plotësisht në organizatë dhe janë në funksion. Për shembull: organizata ka hartuar një program vjetor në mënyrë pjesëmarrëse, i cili integron aspektet kryesore të punës, siç janë: qëllimet, rezultatet dhe aktivitetet me buxhetin e planifikuar, resurset njerëzore, plani i zhvillimit dhe plani i komunikimeve.
- Ekziston pjesërisht ose është në zhvillim; rrallë ose aspak nuk zbatohet në praktikë: Ky nivel nënkupton se për një pjesë ose për të gjitha kërkesat/kriteret/shembujt që përmbahen në definicionin e atij indikatorit/standardi ka filluar procesi i përgatitjes/hartimit. Gjithashtu në këtë nivel do të vendosen edhe të gjitha ato raste në të cilat ekzistojnë kërkesat/kriteret/shembujt e cekur, por ose të gjitha ose një pjesë e tyre nuk janë në funksion apo zbatohen në mënyrë joadekuate. Për shembull, organizata ka hartuar një program vjetor në mënyrë pjesëmarrëse, i cili nuk integron tërësisht aspektet kryesore të punës, gjegjësisht bazohet në objektivat, rezultatet, aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar, por nuk i përfshin aspektet e tjera të cilat i përfshin standardi.
- Nuk ekziston: Ky nivel nënkupton se kërkesat/kriteret/shembujt që përmbahen në definicionin e atij indikatorit/standardi nuk janë të përmbushura aspak. Madje edhe nëse ka elemente që tregojnë se ekzistojnë disa prej kërkesave, megjithatë konsiderohet se ato nuk ekzistojnë.

Kjo shkallë e zhvillimit është e dobishme sepse:

- Përcakton standardet minimale të cilat duhet t'i përmbushë një organizatë që të mund të standardizohet në nivel themelor,

- Jep drejtimin se ku duhet të lëvizë organizata në zhvillimin e mëtejshëm.

Nëse disa indikatorë/standarde nuk janë relevante për organizatën (për shembull, nëse organizata nuk është e orientuar për realizimin e shërbimeve), atëherë në procesin e vetëvlerësimit mund të merret një vendim që të përjashtohet ajo fushë.

Për çdo indikator/standard janë zhvilluar pyetje në bazë të të cilave ekipi i vetëvlerësimit në organizatë diskuton dhe zgjedh një nga tre nivelet e ofruara. Gjithashtu, për çdo vendim të marrë se në cilin nivel pozicionohet organizata në ndonjë indikator/standard shkruhet një rezime të shkurtër të diskutimit dhe argumenteve kryesore në favor të vendimit të marrë.

Gjithashtu, për çdo indikator/standard, është ofruar një set formularësh dhe veglash për një menaxhim më të lehtë të cilësisë. Organizata gjatë zgjedhjes së nivelit në të cilin gjendet, përzgjedh se cilët formularë i përdor nga ata që janë cekur, si dhe formularët e nevojshëm që dëshiron t'i aplikojë.

Në vazhdim është Vegla e vlerësimit në të cilën janë shpjeguar dhe definuar hollësisht të gjitha fushat dhe standardet individuale, si dhe nivelet e zhvillimit.

4.

Hapat e aplikimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë

Hapi 1 – Marrja e vendimit për aplikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë

Parakushti themelor që të fillohet me aplikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë është që organizata të marrë vendim për aplikimin e tij dhe të përcaktojë se cili model do të përdoret. Marrja e vendimit nënkupton që anëtarët dhe të punësuarit e organizatës t'i njohin përfitimet e aplikimit të një sistemi të tillë dhe të zotohen për përdorimin e sistemit në punën e çdoditshme. Marrja e vendimit, përveç kontratës së të punësuarve dhe anëtarëve dhe përzgjedhjes së modelit, përfshin edhe përzgjedhjen e metodave sipas të cilave do të konstatohet niveli i përmbushjes së disa prej standardeve. Vendimmarrja duhet të bëhet nga ana e Bordit drejtues dhe të mbështetet zyrtarisht.

Varësisht nga modeli, mund të ketë qasje të ndryshme, kështu që, siç u tha më lart, në modelin e adaptuar sipas nevojave të shoqërisë civile në Maqedoni, rekomandohet që qasja e vetëvlerësimit të mbikëqyrur të jetë në gjendjen fillestare. Kjo qasje nënkupton përfshirjen e personave të jashtëm që ndihmojnë ekipin e vetëvlerësimit për të kryer vlerësimin. Në këtë rast, edhe pse janë përfshirë persona të jashtëm, përgjegjësia për vendimin përfundimtar në lidhje me nivelin në të cilin do të pozicionohet organizata sipas standardeve të ndryshme është dhënë për ekipin e brendshëm ose për trupat relevantë në organizatë, të cilët në fund duhet ta miratojnë raportin e vetëvlerësimit të organizatës.

Hapi 2 – Formimi i ekipit për aplikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë

Përbërja e ekipit që duhet të zbatojë një vlerësim të gjendjeve varet nga vetë organizata dhe nga natyra dhe dinamika e punës së saj. Numri i anëtarëve të ekipit mund të ndryshojë në varësi të madhësisë së organizatës dhe numrit të të punësuarve dhe anëtarëve, por është e rëndësishme të sigurohet një numër optimal njerëzish, të cilët do të pajtohen të marrin pjesë në vlerësim. Kjo do të thotë se ekipi do të duhej të përfshinte të paktën 3, por jo më shumë se 12 persona. Kombinimi ideal i anëtarëve të ekipit do të përfshinte:

- Përfaqësues nga nivele të ndryshme hierarkike të organizatës (për shembull persona nga Kuvendi, Bordi drejtues ose nga pjesa ekzekutive);
- Përfaqësimi barabartë sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike (gjithsesi edhe kritere të tjera relevante);
- Përfaqësues me ekspertizë specifike në fushëveprimin e organizatës;
- Përfaqësues me një përvojë të rëndësishme menaxheriale në organizatë;

- Përfaqësues që kanë njohuri të mira të sektorit civil;
- Përfaqësues që kanë kompetencë të marrin vendime për organizatën (për shembull kryetari, drejtori ekzekutiv etj.) me qëllim që t'i sigurohet një legjitimitet procesit të vlerësimit;
- Bashkëpunëtorë të jashtëm të organizatës.

Megjithatë, në realitet, gjithmonë nuk mund të merren parasysh të gjitha kriteret. Organizata duhet të përpiqet të sigurojë një ekip me përbërje dhe me kapacitete optimale që ta kryejë vlerësimin. Kriteret e mëposhtme mund të konsiderohen si të domosdoshme:

- Përfshirja e personave që kanë autorizim të marrin vendime;
- Përfshirja e personave të niveleve të ndryshme të organizatës;
- Përfshirja e personave me një përvojë të rëndësishme menaxheriale.

Organizata duhet të zgjedhë një anëtar nga ekipi, i cili do të ketë rolin e udhëheqësit të ekipit. Rekomandohet që anëtarët e ekipit të mos ndryshohen derisa zgjat procesi i vlerësimit.

Hapi 3 – Takimet e punës të ekipit për vlerësimin e gjendjeve në organizatë

Në përputhje me elementet e zhvilluara të sistemit të menaxhimit të cilësisë, ekipi për zbatim të vlerësimit me përdorimin e Veglës së vlerësimit në takimet e punës duhet të kryejë vlerësim të gjendjeve në organizatë. Vegla mund të mbushet përmes një diskutimi plenar të ekipit, por nëse ekipi numëron mbi 8 persona, rekomandohet të formohen grupe më të vogla pune brenda të cilave do të zbatohet vlerësimi i të gjitha fushave të veglës, e pastaj përmes një diskutimi plenar do të harmonizohen dallimet mes grupeve më të vogla të punës. Gjatë diskutimeve plenare rekomandohet të sigurohet një shkruar procesverbal, i cili do të marrë shënime gjatë diskutimeve dhe në fund të vlerësimit do të përpilojë procesverbalin, i cili pastaj është baza për draft-raportin e vlerësimit. Në përputhje me madhësinë e Veglës së vlerësimit, rekomandohet që të realizohen 3-4 takime pune gjysmëditore të ekipit në periudhë prej një jave. Rekomandohet që takimet e punës të ekipit t'i mbikëqyrë një konsulent i jashtëm, i cili do të jetë i informuar mirë për metodologjinë dhe veglën e punës dhe në detaje e njeh punën e organizatave të shoqërisë civile.

Gjatë takimeve të punës, ekipi mund të vendosë të përdorë edhe vegla të tjera ndihmëse me qëllim që të bëjë vlerësim më të lehtë dhe më objektiv. Vegla të tilla mund të jenë analiza SWOT, analiza e ciklit jetësor, etj. (në vazhdim janë shembujt e veglave).

Hapi 4 – Grumbullimi i mendimeve dhe qëndrimeve nga palët e jashtme dhe përdoruesit e interesuar

Përmes këtij hapi grumbullohen të dhënat nga palët e jashtme të interesuara relevante për punën e organizatës. Mendimi i palëve të jashtme shërben si informacion shtesë për vlerësimin e zbatuar nga ana e ekipit me qëllim që të

sigurohet një objektivitet më i madh duke përdorur këndvështrimin e jashtëm ndaj organizatës. Rekomandohet që ekipi i vlerësimit të hartojë një listë të aktorëve të jashtëm që duhet të përfshihen në vlerësim. Ata mund të përfshihen në shumë mënyra, si për shembull: përmes një interviste, përmes grupeve të fokusit, përmes një takimi të përbashkët të të gjitha palëve të interesuara, përmes pyetësorit e kështu me radhë. Në vazhdim është dorëzuar edhe një propozim-pyetësor për palët e jashtme të interesuara.

Informacioni i grumbulluar nga palët e jashtme duhet të analizohet dhe në formën e një raporti duhet t'i prezantohet ekipit të vetëvlerësimit. Për të zbatuar këtë hap, është më mirë që ekipi i vetëvlerësimit të formojë një grup më të vogël pune.

Nëse organizata ka një anëtarësi të madhe, ose në qoftë se bëhet fjalë për rrjete apo koalicione, atëherë është mirë që vegla e vetëvlerësimit t'i jepet një përfaqësuesi të përzgjedhur të anëtarësisë (ose t'u jepet të gjitha organizatave anëtare në qoftë se bëhet fjalë për një lloj organizate të rrjetëzuar), me qëllim që ta plotësojnë atë dhe pastaj informacioni i grumbulluar të analizohet dhe t'i dërgohet ekipit të vlerësimit.

Pas grumbullimit të informacionit të tërësishëm, si nga takimet e punës të ekipit të vlerësimit, ashtu edhe nga palët e jashtme të interesuara dhe anëtarësia, udhëheqësi i ekipit harton një raport nga vlerësimi me rekomandime për veprimet e mëtejshme në organizatë. Një shembull i formatit të raportit është dhënë në vazhdim.

Hapi 5 – Finalizimi i vendimit për gjendjet e konstatuara në organizatë

Gjetjet e raportit prezantohen para ekipit të vetëvlerësimit dhe diskutohet për ndryshimet dhe plotësimet eventuale të raportit. Në fund të takimit të ekipit merret vendimi përfundimtar, azhurnohen raporti dhe dokumentet dhe anekset e hartuara shoqëruese dhe ato ndahen me të gjithë ata që kanë marrë pjesë në vlerësim, si nga ekipi ashtu edhe nga palët e jashtme. Takimin për marrjen e vendimit përfundimtar e mbikëqyr një konsulent i jashtëm.

Hapi 6 - Përzgjedhja e prioriteteve zhvillimore dhe zhvillimi i planit aksionar

Në një takim të veçantë të ekipit të vetëvlerësimit, përmes një diskutimi plenar përzgjidhen prioritetet zhvillimore. Përzgjedhja e prioriteteve mund të kryhet me përdorimin e veglës ndihmëse Matrica e prioriteteve, e cila është dhënë në vazhdim, kështu që duhet të kihet kujdes për aspektet e mëposhtme:

- Të përfshihen ato fusha në të cilat organizata është në nivelin më të ulët të zhvillimit;
- Të përfshihen fushat në të cilat organizata ka një interes të veçantë për t'i përmirësuar ato;
- Të përfshihen aq prioritete sa që do të ketë kapacitet organizata të realizojë përmirësime në periudhën e ardhshme prej 1 – 3 vjet.

Në bazë të prioriteteve të përzgjedhura, me ndihmën e konsulentit të jashtëm përgatitet një plan aksionar për përmirësimin e gjendjeve, në të cilin përfshihen aktivitetet e domosdoshme të cilat duhet të sigurojnë avancimin e organizatës dhe

të definoohen qartë rezultatet e pritshme afatshkurtra dhe afatgjata. Plani aksionar duhet ta përfshijë edhe dinamikën kohore, si dhe personat përgjegjës për zbatimin e planit. Një shembull i formatit të planit është dhënë në vazhdim.

Plani i përgatitur së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të vlerësimit dërgohet për miratim në Bordin drejtues të organizatës.

Hapi 7 – Zbatimi dhe ndjekja e planit aksionar për përmirësimin e gjendjeve

Përgjegjësinë kryesore për zbatimin e planit aksionar e ka drejtori ekzekutiv ose presidenti i organizatës. Gjithashtu, Bordi drejtues duhet të përfshihet në mënyrë aktive në sigurimin e mbështetjes financiare për zbatimin e aktiviteteve të planit. Aktivitetet e planit aksionar duhet të përfshihen si një segment përbërës të të gjitha aplikacioneve të projekteve që ofrojnë mundësi për mbështetjen e zhvillimit institucional të organizatës. Paralelisht me zbatimin e projekteve dhe programeve, organizata duhet të monitorojë edhe zbatimin e planit dhe të ndërmarrë masat e duhura korrektuese nëse është e nevojshme.

Hapi 8 – Vlerësimi i serishëm i rezultateve të realizuara me përmirësime

Pas kalimit të periudhës kohore e cila është përcaktuar për zbatimin e planit, ekipi që ka zbatuar vlerësimin, në fillim përsëri duhet të zbatojë një vlerësim në të njëjtën mënyrë me qëllim që të bëjë një konstatim të serishëm të gjendjeve dhe të konstatohen përmirësimet dhe ndryshime të arritura, ose në disa situata edhe ngecje në zhvillim. Në vlerësimin e serishëm është mirë që të përfshihen aktorët e njëjtë si në fillim, që do të thotë se nëse kanë qenë të përfshira edhe palët e jashtme edhe anëtarësia në fillim të vlerësimit, pritët që ato të përfshihen edhe në vlerësimin e serishëm.

Nga vlerësimi i serishëm hartohet një raport me rekomandime dhe prioritete që duhet të përfshihen në ciklin e ardhshëm të ri të përmirësimeve.

Hapi 9 – Fillimi i ciklit të ri të përmirësimeve

Pas raportit të hartuar dhe të miratuar nga vlerësimi i serishëm, ai ndahet me të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në vlerësimin e serishëm. Pastaj hartohet një plan aksionar për ciklin e ri të përmirësimeve dhe ai zbatohet.

5. Shtojcat

Shtojca 1 – Vegla për aplikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë

Shtojca 2 – Vegla për jetëgjatësinë e organizatës

Shtojca 3 – Kërkesa për pagesë nga arka

Shtojca 4 – Kërkesa për mungesë

Shtojca 5 – Format i për raportin narrativ të vetëvlerësimit

Shtojca 6 – Formulari për harxhimet e udhëtimit

Shtojca 7 – Matrica për përcaktimin e prioriteteve zhvillimore

Shtojca 8 – Plani për ndërtimin e kapaciteteve

Shtojca 9 – Pyetësi për palët e jashtme

Shtojca 10 – Format i për evidencën e orarit të punës

Shtojca 11 – Terminologjia

SISTEMI I CILËSISË NË MENAXHIMIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Propozim-fushat dhe kategoritë e modelit

Qendra për hulumtim e krijim të politikave,
Elizabeta Markovska Spasenoska – konsulent për zhvillimin organizativ 10/1/2017

Karakteristikat themelore të Sistemit të cilësisë në menaxhimin e organizatave të shoqërisë civile (SCM)

- Ky sistem është një propozim-model për menaxhim cilësor, i cili duhet të zhvillohet deri në fund dhe të finalizohet përmes grupeve të fokusit dhe konsultimeve me një grup të organizatave të shoqërisë civile, organizata që kanë fituar grante në programin CIVICA Mobilitas. Grupi i organizatave përfshin përfaqësues që vijnë nga organizata me përvojë të ndryshme, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme tematike të veprimit dhe kanë një koncept të ndryshëm të punës.

- Ky sistem do të përfshijë me vete një Doracak për aplikimin e sistemit në organizatat e shoqërisë civile dhe një set formularësh dhe veglash manuale për cilësinë e menaxhimit. Në dizajnin e këtij propozim-modeli janë të përfshira përvojat ndërkombëtare dhe rajonale, të dhënat nga intervistat e realizuara me 15 organizata të shoqërisë civile, të dhënat e projekteve dhe procesit të vetëvlerësimit në kuadër të programit CIVICA Mobilitas, përvojat e konsulentit në zbatimin e më shumë se 15 proceseve të vlerësimit të organizatës dhe vetëvlerësimi në kuadër të programeve dhe projekteve ndërkombëtare dhe vendase, si dhe qëndrimet dhe mendimet e koordinatorëve të granteve të programit Civica Mobilitas në bazë të praktikave të punës së organizatave që kanë fituar grante në program.

- Ky model është harmonizuar me Global standard for CSO accountability <http://www.csostandard.org/the-global-standard/>
- Modeli i propozuar i sistemit të cilësisë së menaxhimit përfshin 10 fusha të cilat përmbajnë në vete 33 standarde për aspekte të ndryshme të punës. Fushat e propozuara janë:

1. Menaxhimi strategjik;
2. Menaxhimi me përdoruesit, anëtarësinë, përkrahësit dhe vullnetarët;
3. Puna në projekte;
4. Përfaqësimi;
5. Realizimi i shërbimeve dhe përkujdesja për përdoruesit;
6. Bashkëpunimi, partneritetet dhe rrjetëzimi;
7. Udhëheqja dhe struktura;
8. Menaxhimi i resurseve njerëzore;
9. Financat dhe administrata;
10. Komunikimet me opinion.

Paralelisht me këto kategori, gjatë aplikimit të standardit, çdo organizatë duhet të përgatisë një listë të vlerave dhe parimeve të funksionimit dhe përmes proceseve dhe procedurave, të cilat i praktikon në kuadër të 10 fushave të cekura, të tregojë se si ato vlera dhe parime janë inkorporuar dhe si zbatohen. Në listën e vlerave do të mund të përfshiheshin: barazia gjinore, përfshirja e individëve, gru-

peve dhe komuniteteve të ndryshme, pjesëmarrja e përbashkët në vendimmarrje, transparenca, besimi dhe respektimi i ndërsjellë e kështu me radhë.

- Modeli zbatohet në mënyrë optimale me zbatimin e metodës së vetëvlerësimit të mbikëqyrur, kurse vetëvlerësimi kryhet sipas indikatorëve që janë të vendosur për secilën fushë dhe në një shkallë me tre nivele:
 - Ekziston dhe zbatohet: Ky nivel nënkupton se kërkesat/kriteret/shembujt që përmbahen në definicionin e atij indikator/standardi janë përmbushur plotësisht në organizatë dhe janë në funksion. Për shembull: organizata ka hartuar një program vjetor në mënyrë pjesëmarrëse, i cili integron aspektet kryesore të punës, siç janë: qëllimet, rezultatet dhe aktivitetet me buxhetin e planifikuar, resurset njerëzore, plani i zhvillimit dhe plani i komunikimeve.
 - Ekziston pjesërisht ose është në zhvillim; rrallë ose aspak nuk zbatohet në praktikë: Ky nivel nënkupton se për një pjesë ose për të gjitha kërkesat/kriteret/shembujt që përmbahen në definicionin e atij indikator/standardi ka filluar procesi i përgatitjes/hartimit. Gjithashtu në këtë nivel do të vendosen edhe të gjitha ato raste në të cilat ekzistojnë kërkesat/kriteret/shembujt e cekur, por ose të gjitha ose një pjesë e tyre nuk janë në funksion apo zbatohen në mënyrë joadekuate. Për shembull, organizata ka hartuar një program vjetor në mënyrë pjesëmarrëse, i cili nuk integron tërësisht aspektet kryesore të punës, gjegjësisht bazohet në objektivat, rezultatet, aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar, por nuk i përfshin aspektet e tjera të cilat i përfshin standardi.
 - Nuk ekziston: Ky nivel nënkupton se kërkesat/kriteret/shembujt që përmbahen në definicionin e atij indikator/standardi nuk janë të përmbushura aspak. Madje edhe nëse ka elemente që tregojnë se ekzistojnë disa prej kërkesave, megjithatë konsiderohet se ato nuk ekzistojnë.
- Për çdo indikator/standard janë zhvilluar pyetje në bazë të të cilave ekipi i vetëvlerësimit në organizatë diskuton dhe zgjedh një nga tre nivelet e ofruara. Gjithashtu, për çdo vendim të marrë se në cilin nivel pozicionohet organizata në ndonjë indikator/standard shkruhet një rezymë të shkurtër të diskutimit dhe argumenteve kryesore në favor të vendimit të marrë.
- Gjithashtu, për çdo indikator/standard, është ofruar një set formularësh dhe veglash për një menaxhim më të lehtë të cilësisë. Organizata gjatë zgjedhjes së nivelit në të cilin gjendet, përzgjedh se cilët formularë i përdor nga ata që janë cekur, si dhe formularët e nevojshëm që dëshiron t'i aplikojë.
- Propozohet aplikimi i seteve të ndryshme të standardeve të nivelit themelor/bazik, e pastaj lart si shkalla e zhvillimit në të cilën mund të pozicionohet organizata pas vetëvlerësimit të zbatuar. Kjo shkallë e zhvillimit është e dobishme sepse:
 - Përcakton standardet minimale të cilat duhet t'i përmbushë një organizatë që të mund të standardizohet në nivelin themelor;
 - Jep drejtimin se ku duhet të lëvizet organizata në zhvillimin e mëtejshëm.
 - Nëse disa indikatorë/standarde nuk janë relevante për organizatën (për shembull, nëse organizata nuk është e orientuar për realizimin e shërbimeve), atëherë në procesin e vetëvlerësimit mund të merret një vendim që të përjashtohet ajo fushë.
 - Në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit mund të qaset edhe kah verifikimi i jashtëm i sistemit në bashkëpunim me Institutin e Standardizimit. Si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të cilësisë së menaxhimit mund të përdoret versioni më i ri i standardit ISO 9001:2015.

Indikator/standardi 1.1 Planifikimi strategjik – Me këtë standard konstatohet ekzistimi dhe zbatimi i një procesi të vendosur të planifikimit strategjik, zbatimi i strategjisë dhe monitorimi i zbatimit

Harmonizuar me Global standard for CSO accountability:

Cluster A: What we want to achieve;

Lasting change: We will deliver long-term positive results.

Dokumentet referente

Harta e një procesi të definuar të planifikimit strategjik, planit të hartuar aktual ose planeve paraprake strategjike, raporteve të realizimit dhe/ose revizionit të strategjisë së organizatës

Definicioni i indikatorit/ standardit	Pyetje për diskutim	Shkalla e vetëvlerësimit (në nivelin e zgjedhur shkruani gjendjen faktike)			Formularët dhe veglat
		Ekziston dhe zbatohet	Ekziston pjesërisht ose është në zhvillim; zbatohet rrallë ose nuk zbatohet aspak	Nuk ekziston	
Organizata drejton një proces të përcaktuar saktë të planifikimit strategjik, që është regjistruar, shpjeguar ose treguar me grafik dhe i cili me vete përfshin elementet e planifikimit dhe zbatimit të strategjisë, si dhe raportimin e realizimit të saj.	<p>Si duket procesi ynë i planifikimit strategjik?</p> <p>A është regjistruar ose treguar me grafik procesi ynë?</p> <p>A kanë njohuritë gjithë të punësuarit ose bartësit e vendimeve në organizatë për procesin?</p> <p>A marrin pjesë të gjithë të punësuarit në organizatë dhe bartësit e vendimeve në të?</p> <p>A janë përfshirë mjaftë, konstituentët, anëtarët ose përkrahësit tanë në planifikimin strategjik?</p>				<p>Harta e procesit të planifikimit strategjik, zbatimit dhe raportimit</p> <p>Procedura e shkruar e planifikimit strategjik</p> <p>Shembulli/modeli i strategjisë</p> <p>Shembulli/modeli i raportit të strategjisë</p> <p>Seti i veglave që përdoren në proces (PEST, SWOT, Matrica e prioritetëve etj.)</p>

Rezumeja e argumenteve kryesore në mbështetjen e nivelit të përzgjedhur:

Indikator/standardi 1.2 Planifikimi i integruar vjetor – Me këtë standard konstatohet ekzistimi dhe zbatimi i një procesi të përcaktuar të planifikimit të integruar vjetor, zbatimi i programit vjetor dhe monitorimi i zbatimit

Harmonizuar me Global standard for CSO accountability:

Cluster A: What we want to achieve;

Lasting change: We will deliver long-term positive results.

Dokumentet referente

Harta e një procesi të definuar të planifikimit vjetor, programit të hartuar aktual ose programit paraparak vjetor, raporteve të realizimit dhe/ose revizionit të programit vjetor të organizatës

Definicioni i indikatorit/ standardit	Pyetje për diskutim	Shkalla e vetëvlerësimit (në nivelin e zgjedhur shkruani gjendjen faktike)			Formularët dhe veglat
		Ekziston dhe zbatohet	Ekziston pjesërisht ose është në zhvillim; zbatohet rrallë ose nuk zbatohet aspak	Nuk ekziston	
Organizata drejton një proces të përcaktuar saktë të planifikimit të integruar vjetor, që është regjistruar, shpjeguar ose treguar me grafik dhe i cili me vete përfshin elementet e planifikimit dhe zbatimit të programit vjetor, si dhe raportimin e realizimit të tij. Planifikimi vjetor del nga strategjia dhe përfshin elementet e planifikimit financiar, resurset njerëzore, marrëdhëniet me opinion dhe zhvillimin e organizatës.	<p>Si duket procesi ynë i planifikimit të integruar vjetor?</p> <p>A është regjistruar ose treguar me grafik procesi ynë?</p> <p>A kanë njohuri të gjithë të punësuarit ose bartësit e vendimeve në organizatë për procesin dhe marrin pjesë në të?</p> <p>A janë përfshirë mjaftë konstituentët, anëtarët ose përkrahësit tanë në planifikimin vjetor?</p>				<p>Harta e procesit të planifikimit të integruar vjetor, zbatimit dhe raportimit</p> <p>Procedura e shkruar e planifikimit të integruar vjetor</p> <p>Shembulli/modeli i programit vjetor</p> <p>Shembulli/modeli i raportit vjetor</p> <p>Seti i veglave që përdoren në proces (SWOT, Matrica e prioriteteve etj.)</p>

Rezimeja e argumenteve kryesore në mbështetjen e nivelit të përzgjedhur:

Indikatori/standardi 1.3 Qëndrueshmëria financiare – Me këtë standard konstatohet kapaciteti i organizatës që të sigurojë fonde për punë dhe zhvillim në vazhdimësi dhe ekzistimi i planeve dhe drejtimeve për qasje në burimet kryesore të financimit

Harmonizuar me Global standard for CSO accountability:

Cluster C: What we do internally;

Well-handled resources: We will handle our resources responsibly to reach our goals and serve the public good.

Dokumentet referente

Strategjia e azhurnuar për mbledhjen e mjeteve financiare, plani i mbledhjes së mjeteve financiare, buxheti i vetëm i organizatës i të ardhurave dhe të dalave, bazat ekzistuese të të dhënave për donatorët potencialë, përshkrimet e vendeve të punës të personelit

Definicioni i indikatorit/ standardit	Pyetje për diskutim	Shkalla e vetëvlerësimit (në nivelin e zgjedhur shkruani gjendjen faktike)			Formularët dhe veglat
		Ekziston dhe zbatohet	Ekziston pjesërisht ose është në zhvillim; zbatohet rrallë ose nuk zbatohet aspak	Nuk ekziston	
